

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

**LOTI II - “OFRIMI I SHËRBIMIT ONLINE PËR MONITORIMIN E TRAFIKUT
URBAN – SHËRBIM DATA NËPËRMJET KARTAVE SIM”**

Tiranë, 2026

PËRMBLEDHJE

Përfituesi / Autoriteti Kontraktues	3
Hyrje	3
Qëllimi	3
INFRASTRUKTURA	3
Shërbimi DATA Mobile duhet të shërbejë si mekanizëm alternativ komunikimi (redundancë) për infrastrukturën e komunikimit të sistemit TOCC, duke siguruar vazhdimësinë e transmetimit të të dhënave në rast të ndërprerjes ose mosdisponueshmërisë së lidhjeve kryesore të komunikimit me fibër optike.	4
Sistemi i Monitorimit dhe Menaxhimit të Sistemeve të Trafikut Urban TOCC me Data SIM Card	4
Karakteristikat e Rrjetit	9
Indikatorët e cilësisë.	9
Instalimet e Rrjetit	10
Funksionimi i Rrjetit	10
Operatori ekonomik është përgjegjës për:	10
Monitorimi i rrjetit	11
Mirëmbajtja e rrjetit	11
Raportimi	11
Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit	11

Përfituesi / Autoriteti Kontraktues

Bashkia e Tiranës/ Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor.

Hyrje

Një shërbim i besueshëm dhe cilësor në internet është një domosdoshmëri absolute për Qendrën e Monitorimit të Trafikut TOCC. Kërkesat janë të larta, shërbimi shumë kritik dhe ndërprerjet janë të patolerueshme.

Qendra e Monitorimit të Trafikut e cila menaxhohet nga Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor, me adresë Rr. “Myrtezim Këllici”, pranë Gjimnazit Profesional Ekonomik, ka në administrimin e saj 74 kryqëzime semaforike (NUTC), 67 kamera survejimi (CCTV) në kryqëzimet më të rëndësishme të Tiranës, nga të cilat 55 janë në të njëjtën vendndodhje me kryqëzimet semaforike.

Përveç infrastrukturës kryesore të komunikimit me fibër optike, për të shmangur ndërprerjet dhe për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit, është i nevojshëm dhe domosdoshëm një mekanizëm alternativ komunikimi.

Për këtë arsye, kërkohet ofrimi i shërbimit DATA nëpërmjet kartave SIM, të cilat do të përdoren si lidhje backup për vendndodhjet e caktuara në këtë dokument, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Qëllimi

Qëllimi i këtij loti është garantimi i vazhdimësisë së komunikimit të sistemit TOCC nëpërmjet kartave SIM

Nëpërmjet kësaj kontrate synohet:

- garantimi i komunikimit rezervë (backup);
- rritja e disponueshmërisë së sistemit;
- eliminimi i ndërprerjeve të komunikimit;
- garantimi i parametrave të SLA.

INFRASTRUKTURA

Bashkia e Tiranës nëpërmjet kësaj kontrate kërkon të plotësohen kushtet teknike për ofrimin e shërbimit sipas kërkesave të paraqitura në këtë dokument.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbimin DATA nëpërmjet kartave SIM me shpejtësi 3G/LTE/4G ose 5G aty ku është i disponueshëm, për pajisjet e sistemit të monitorimit dhe menaxhimit të trafikut urban.

Shërbimi DATA Mobile duhet të shërbejë si mekanizëm alternativ komunikimi (redundancë) për infrastrukturën e komunikimit të sistemit TOCC, duke siguruar vazhdimësinë e transmetimit të të dhënave në rast të ndërprerjes ose mosdisponueshmërisë së lidhjeve kryesore të komunikimit me fibër optike.

Sistemi i Monitorimit dhe Menaxhimit të Sistemeve të Trafikut Urban TOCC me Data SIM Card

Më poshtë jepet lista e pikave për të cilat kërkohet shërbim nëpërmjet kësaj kontrate.

Pikat/vendndodhjet e mëposhtme kanë lidhje Dark Fiber me Qendrën e Monitorimit të Bashkisë Tiranë. Këto lidhje realizohen me anë të Fibrës Optike (Dark fiber) dhe terminohen në ndërfaqe optike të cilat ndodhen në Bashkinë e Tiranës, konkretisht tek Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor me adresë tek Rr. “Myrtezim Këllici” pranë Gjimnazit Profesional Ekonomik. Për secilën prej këtyre pikave, kërkohet dhe shërbim Data nëpërmjet SIM card si linjë backup i tyre.

Operatori ekonomik është përgjegjës për furnizimin, aktivizimin, konfigurimin dhe administrimin e të gjitha kartave SIM gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Tabela 1

Nr .	Emertimi	Vendndodhja	CCTV	Shërbimi me fibër Optike	Afati/ Dite
1		Sheshi Willson	CCTV06	data SIM Card	731 ditë
2	NUTC8	Banke- Muze	CCTV 8.1 & CCTV 8.2	data SIM Card	731 ditë
3	NUTC9	Hotel Dajti	CCTV 9.1 & CCTV 9.2	data SIM Card	731 ditë
4	NUTC10	Shkolla Vasil Shanto	CCTV 10.1 & CCTV 10.2	data SIM Card	731 ditë
5	NUTC11	Tajvani	CCTV 11.1 & CCTV 11.2	data SIM Card	731 ditë
6	NUTC12	Rr. Ndre Mjeda	CCTV12	data SIM Card	731 ditë
7	NUTC14	Ura Teknollogjike	CCTV14	data SIM Card	731 ditë
8	NUTC15	21 Dhjetori	CCTV15	data SIM Card	731 ditë
9	NUTC16	Unaza-M.Shyri		data SIM Card	731 ditë
10	NUTC17	Ura Rr. Elbasanit	CCTV 17.1 & CCTV 17.2	data SIM Card	731 ditë
11	NUTC18	Liceu	CCTV18	data SIM Card	731 ditë

12	NUTC19	RTSH	CCTV19	data SIM Card	731 ditë
13	NUTC20	Ministria e Drejtesise	CCTV20	data SIM Card	731 ditë
14	NUTC21	Libri Universitar	CCTV21	data SIM Card	731 ditë
15	NUTC22	Presidenca	CCTV22	data SIM Card	731 ditë
16	NUTC23	Kryeministria	CCTV23	data SIM Card	731 ditë
17	NUTC24	Ministria Rendit	CCTV24	data SIM Card	731 ditë
18	NUTC25	Gjykata e Larte	CCTV25	data SIM Card	731 ditë
19	NUTC26	INSIG	CCTV26	data SIM Card	731 ditë
20	NUTC27	Ushtari Panjohur	CCTV27	data SIM Card	731 ditë
21	NUTC28	Shkolla Bajram Curri	CCTV28	data SIM Card	731 ditë
22	NUTC29	Rr. Kont Urani	CCTV29	data SIM Card	731 ditë
23	NUTC30	Inxhinieria Ndertimit	CCTV30	data SIM Card	731 ditë
24	NUTC31	Stadiumi Dinamo	CCTV31	data SIM Card	731 ditë
25	NUTC32	Rr. Abdyl Frasheri-Rr. Vaso Pasha	CCTV32	data SIM Card	731 ditë
26	NUTC33	Rr. Komuna Parisit	CCTV33	data SIM Card	731 ditë
27	NUTC34	Ministria Arsimit	CCTV34	data SIM Card	731 ditë
28	NUTC35	ATSH	CCTV 35.1 & CCTV 35.2	data SIM Card	731 ditë
29	NUTC36	Rr. Mine Peza	CCTV36	data SIM Card	731 ditë
30	NUTC37	Drejtoria e Policise	CCTV 37.1 & CCTV 37.2	data SIM Card	731 ditë
31	NUTC38	Sheshi Kombinat	CCTV38	data SIM Card	731 ditë
32	NUTC39	Rr. Qelqit		data SIM Card	731 ditë
33	NUTC40	Shkolla e Gjuheve te Huaja	CCTV40	data SIM Card	731 ditë
34	NUTC41	Shkolla Qemal Stafa		data SIM Card	731 ditë

35	NUTC42	Shkolla Misto Mame		data SIM Card	731 ditë
36	NUTC 43	Bulevardi Ri/Filip Jano		data SIM Card	731 ditë
37	NUTC44	Ish Ekspozita		data SIM Card	731 ditë
38	NUTC45	Rr. Irfan Tomini/ Blv. Gjergj Fishta	CCTV45	data SIM Card	731 ditë
39	NUTC46	Rr. Xhanfize Keko / Rr. Sadik Petrela	CCTV46	data SIM Card	731 ditë
40	NUTC47	Rr. Kavajes / Rr 3 Deshmoret	CCTV47	data SIM Card	731 ditë
41	NUTC48	Laprake	CCTV48	data SIM Card	731 ditë
42	NUTC52	Rruga Lord Bajron / Rr. Pandi Dardha		data SIM Card	731 ditë
43	NUTC53	Unaze / Rr. Don Bosko	CCTV53	data SIM Card	731 ditë
44	NUTC54	Unaze / Rr. Jordan Misja	CCTV54	data SIM Card	731 ditë
45	NUTC55	Unaze / Blv. Zogu Pare	CCTV55	data SIM Card	731 ditë
46	NUTC56	Unaze / Rr. Barrikadave	CCTV56	data SIM Card	731 ditë
47	NUTC57	Unaze / Rr. Siri Kodra	CCTV57	data SIM Card	731 ditë
48	NUTC58	Unaze / Rr. 5 Maji	CCTV58	data SIM Card	731 ditë
49	NUTC59	Unaze / Rr. Dibres	CCTV59	data SIM Card	731 ditë
50	NUTC60	Unaze / Rr. Kongresi Manastirit	CCTV60	data SIM Card	731 ditë
51	NUTC61	Unaze / Rr. Hoxha Tahsim	CCTV61	data SIM Card	731 ditë
52	NUTC62	Brryli	CCTV62	data SIM Card	731 ditë
53	NUTC63	Bulevardi Ri/Lokomotiva		data SIM Card	731 ditë
54	NUTC64	Rr. Kavajes / Rr. Besim Alla	CCTV64	data SIM Card	731 ditë
55	NUTC66	Kupola	CCTV66	data SIM Card	731 ditë
56	NUTC67	Zogu Pare / Rr. Dedë Gjon Luli	CCTV67	data SIM Card	731 ditë


57	NUTC68	Selvia	CCTV68	data SIM Card	731 ditë
58	NUTC69	QSUT		data SIM Card	731 ditë
59	NUTC70	Rr. Ali Demi / Rr. Hasan Sufa		data SIM Card	731 ditë
60	NUTC71	Ura Ministria e Jashtme		data SIM Card	731 ditë
61	NUTC72	Ura Kisha Katolike		data SIM Card	731 ditë
62	NUTC73	Ura UET		data SIM Card	731 ditë
63	NUTC74	URa Gjykata e Tiranës		data SIM Card	731 ditë
64	NUTC76	Blloku Gintash		data SIM Card	731 ditë
65	NUTC78	Qendra Globe		data SIM Card	731 ditë
66	NUTC80	Konferenca e Pezes/Rr.Bego Hoxha		data SIM Card	731 ditë
67	NUTC81	Konferenca e Pezes/Rr. Bubulina		data SIM Card	731 ditë
68	NUTC82	Ura Hotel Hilton		data SIM Card	731 ditë
69	NUTC83	Ish Policia Bashkiake / Rr.Kavajes		data SIM Card	731 ditë
70	NUTC84	Rr. Xhanfize Keko- Rr.Zihni Sako		data SIM Card	731 ditë
71	NUTC85	Bulevardi Ri/Karl Gega		data SIM Card	731 ditë
72	NUTC86	Marteniteti i Ri		data SIM Card	731 ditë
73	NUTC87	Bulevardi Ri/SotirPolena		data SIM Card	731 ditë
74	NUTC88	Bulevardi Ri/Siri Kodra		data SIM Card	731 ditë
75	NUTC99	Blv. Petronini Luarasi / Rr. Todi Shkurti		data SIM Card	731 ditë
76		Diga e Liqenit	CCTV89	data SIM Card	731 ditë
77		Kopshti Zoologjik	CCTV91.1&CCTV 91.2	data SIM Card	731 ditë

78		Kristal	CCTV93	data SIM Card	731 ditë
79		Rrethi Komuna Parisit	CCTV94	data SIM Card	731 ditë
80		Komisariati nr. 4	CCTV95	data SIM Card	731 ditë
81		Rr. Kastriotet (Euroteorema)	CCTV96	data SIM Card	731 ditë
82		Zogu i Zi	CCTV97	data SIM Card	731 ditë
83		Mbikalimi Unazes Fabrika e Miellit	CCTV13	data SIM Card	731 ditë
84		Rr. Elbasanit	CCTV03	data SIM Card	731 ditë
85		IKV	CCTV04	data SIM Card	731 ditë
86	Qendra e Monitorim it të Trafikut		20 (copë)	Sim Card	180 ditë

Shënim: Shërbimi për pikën 86 të tabelës së sipërcituar do të kërkohet kur të lind nevoja sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Aktivizimi do të kryhet vetëm me kërkesë të Autoritetit Kontraktor dhe faturimi do të fillojë nga data e aktivizimit të kartave SIM.

Përshkrimi i Rrjetit

Për Qendrën e Monitorimit, pikat kryesore të rrjetit të nyjeve semaforike dhe kamerave tregohen në diagramën e mëposhtme:



Përshkrimi i rrjetit të backup-it.

Zgjidhja teknike (Ring Last Mile) do jetë primar **Dark Fibër** dhe back up **3G/LTE/4G**.




Figure 240: Backup communication network architecture.

Skema llogjike e rrjetit backup

Karakteristikat e Rrjetit

Shërbimet e specifikuar më sipër duhet të sigurohen, menaxhohen dhe të plotësojnë indikatorët e cilësisë të detajuara më poshtë:

Indikatorët e cilësisë.

- Për pikat: Tabela 1, rrjeti Data Sim Card duhet të jetë i bazuar mbi teknologjinë 3G/LTE/4G në mënyrë që të jetë totalisht i pavaruar nga rrjeti primar.

Kartat SIM duhet të mbështesin:

- komunikim DATA;
- IP dinamike ose statike sipas konfigurimit të operatorit;
- APN privat ose publik sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor;
- funksionim të vazhdueshëm.

Instalimet e Rrjetit

- Mënyra e ofrimit të shërbimit për kartat SIM për lidhjen Sim Card (Lidhje Backup), sipas Tabelës 1 të jetë me transmetim 3G/LTE/4G.
- Kapaciteti i kartave 3G/LTE/4G për shërbimin back-up duhet të jetë unlimited.
- Rrjeti duhet të jetë transparent ndaj mekanizmave QoS të niveleve të tjera që mund të aplikojë vetë përdoruesi.
- Operatori ekonomik duhet të konfigurojë APN sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor pa kosto shtesë.

Funksionimi i Rrjetit

1. Shërbimi duhet të ofrohet 24/7 (24 orë në 7 ditë të javës).
2. Rrjeti i ofruar duhet të lejojë të përdoren software dhe hardware në funksion të aplikimeve që do të përdorë Bashkia Tiranë
3. Rrjeti duhet të jetë virtualisht i izoluar nga rrjetet e përdoruesve të tjerë.
4. Operatori ekonomik duhet të garantojë mbulim të plotë të rrjetit celular në të gjitha vendndodhjet ku ndodhen pajisjet e sistemit TOCC.
5. Në rast se në një pikë konstatohet mungesë mbulimi, operatori ekonomik është përgjegjës për marrjen e masave teknike të nevojshme për sigurimin e shërbimit, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, në të gjitha pikat e përcaktuara në Tabelën 1.
6. Shërbimi DATA duhet të jetë i përshtatshëm për të bashkëvepruar me infrastrukturën e komunikimit të bazuar në Dark Fiber të sistemit TOCC, duke mundësuar funksionimin si lidhje rezervë sipas konfigurimit të Autoritetit Kontraktor.

Operatori ekonomik është përgjegjës për:

- aktivizimin;
- çaktivizimin;
- zëvendësimin;
- administrimin;
- konfigurimin.

Në rast dëmtimi të kartës SIM, operatori duhet ta zëvendësojë brenda 24 orëve.

Monitorimi i rrjetit

Operatori duhet të ofrojë shërbimin “HelpDesk”. Ky shërbim konsiston në mirëmbajtjen e shërbimit nëpërmjet Data Sim Card, asistencë online për të gjithë problemet me rrjetin. Shërbimi Help Desk duhet të jetë i kontaktueshëm nga stafi i Bashkisë 24/7.

Konstatimi dhe riparimi i difekteve:

- Koha e përgjigjes duhet të jetë brenda 10 minutash.
- Koha e zgjidhjes së problemit duhet të jetë brenda 3 orësh.
- Mbështetje aktive në institucion deri në zgjidhjen e problemit.

Mirëmbajtja e rrjetit

- Për çdo problem të mundshëm apo riparim që do të bëjë Operatori përkatës, duhet të lajmërojë minimumi 1 (një) ditë para ndërprerjes.

Raportimi

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë raporte teknike mujore (në mënyrë elektronike ose hard copy) ku do të përshkruajë:

- Raportin dhe detajimin e veprimeve të ndërmarra në rrjet, zgjidhjen e problemeve (detajimi i të gjitha defekteve dhe zgjidhjeve që janë aplikuar), për shërbimin.

Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit

Afati kohor i ofrimit të shërbimit “Tabela I”, do të jetë për një periudhë kohore rreth 2 (dy) vjet / 731 (shtatëqind e tridhjetë e një) ditë, duke filluar nga data e aktivizimit të shërbimit.

Periudha e implementimit/aktivizimit të shërbimit për “Tabela I” do të jetë deri në 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Kartat SIM duhet të dorëzohen të aktivizuara dhe të gatshme për përdorim.

Faturimi do të fillojë në momentin që shërbimi do të jetë aktiv për secilën vendndodhje, brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor.